VENDIM
Nr.767, datë 2.11.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.652, DATË 14.9.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE, "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", PËR VITIN AKADEMIK 2011 - 2012"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 "Për statusin e të verbrit", të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 "Për statusin e invalidit", të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës" dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin 2011 - 2012, të jenë 6966. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit "Master i shkencave"/ "Master i arteve të bukura" 6676;
b) Kuotat për programe të dyta studimi 100;
c) Kuotat për transferimin e studimeve 100;
ç) Kuota për shtetas të huaj 50;
d) Kuotat për personat që nuk shikojnë 20;
dh) Kuotat për romët /ballkano–egjiptianët 20.".

2. Shkronja "a" e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për aplikantët brenda territorit të vendit, 6645".

II. Në fund të tabelës nr.1, që i bashkëlidhej vendimit, shtohen programet e studimit sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha